



RELACION TEKNIK

PRODHIMI DHE PERPUNIMI I METALEVE NE ZONEN INDUSTRIALE, PATOS, QARKU FIER

(Sipas Vendimit nr. 912 datë.11.11.2015)

Subjekti: “APM”SH.P.K

Përgatiti për “GBA STUDIO”: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Denisa Kola', is positioned to the right of the text 'Përgatiti për “GBA STUDIO”: Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA'.

TIRANE 2017



HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit minerar te prodhimit te mineralit ndertimor gurit gelqerore me kariere mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimine ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Projekti tenton permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit, gjate shfrytezimit te tije , si qender rekreative e social- kulturore.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithë zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis u pranua ajo e liste – kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundeshme te ndikimeve dhe nga ana tjeter bartesit e ndikimeve , si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit. Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia dhe veçorite kryesore te morfologjise se rajonit . Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera. Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve

natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

a) Qellimi i Projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte perpunimi i metaleve ne mbeshtetje te plote me kushtet mjedisore me standarte bashkohore, per permbushjen e kerkesave te investitorit per projektin qe do te realizohet, pasurite natyrore dhe humane te zones ne studim, si dhe vlerat e vecanta te tyre. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

b) Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harten topografike siperfaqja e tokes se kerkuar , kufijt e siperfaqes se kerkuar , te dhenat per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.





Pamje nga Google Earth

Sipërfaqja e vënë në dispozicion për zhvillimin e kativitetit ne fjale për prodhimin dhe perpunimin e metaleve me kapacitet vjetor përpunimi prej 3.2 milionë ton, me vendndodhje në Patos – Fier dhe me sipërfaqe 28.288 m², te ndodhura pjesërisht zonen kadastrale Nr.2890 me Nr. pasurie 69/27 dhe 69/29 me koordinata:

Koordinatat GAUS KRUGER

Nr.	E	N
1.	4381695.17	4507944.82

Siperfaqja e tokës ku do të kryhet investimi për aktivitetin ne fjale ndodhet në Patos, per te cilën shoqeria APM shpk disponon nje kontrate qeraje me pronaret e tokave per marrjen ne zhfrytezim te siperfaqes se mesiperme. Shoqëria “APM” sh.p.k detyrohet që në dokumentacionin që do të paraqesë për marrjen e lejes së zhvillimit, të respektojë kërkesat e “Masterplanit”, si dhe të objekteve të tjera të ndërtuara ose në ndërtim.

c) Gjeografia e topografia e zones

Rrethi i Fierit ofron potenciale te rendesishme natyrore per zhvillimin e tij. Ne pergjithesi kemi te bejme me nje rajon fushor me lartesi 0-100 m mbi nivelin e detit dhe me toka shume pjellore. Ne zonat e rrafsha zhvillohen tokat e hirta kafe. Kemi edhe lloje te vecanta tokash si aluvionale qe takohen ne luginat e Semanit e Vjoses, tokat e kripura qe shtrihen ne Hoxhare si dhe tokat mocalishte te Rroskovecit. Ne rrethin e Fierit shtrihet nje pjese e Myzeqes se Madhe, Myzeqeja e Vogel dhe fushat e Frakulles e te Cakrranit. Fieri ashtu si e gjithe Shqiperia ben pjese ne brezin e klimes mesdhetare, dhe dallohet per tipare te shprehura

mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim te madh te diellit dhe dimri i bute dhe me rreshje te medha.

Te dhena hidrogeologjike

Ne kete rajon takohen ujerat nentokesore ne depozitat zhavorr dhe ne nje thellesi 2.7 m deri ne 5.5 m por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon.

Ne siperfaqen e truallit ku do te zhvillohet aktiviteti nuk ka burime siperfaqesore dhe perreth saj nuk ka zona ujore, nuk ndodhen lumenj e liqene. Jane marre masat, ne baze te kondicioneve teknike qe gjate aktivitetit nuk do te kete problem ne hyrjet e daljet e automjeteve ne kete subjekt.

Te dhenat sizmike

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Zona e Fierit eshte zone e prekur nga termetet ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitudo $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copa te suvash por mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

d) Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese perpunuese, sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit

- Karakteristikat kryesore

Ne zonen ku do te zhvillohet ky projekt nuk ka shtepi banimi, shkolla, dhe aktivitete te tjera social kulturore, qe mund te demtohen nga zhvillimi i ketij projekti nga subjekti. Aktiviteti do te zhvillohet ne nje siperfaqe te sheshte, ne kuoten e rruges. Ky studim percakton nje menyre zhvillimi te kesaj zone duke percaktuar disa kriteret parimore mbi zonen, menyren e ndertimit, koeficientin e shfrytezimit te truallit, ushtrimin e projektit etj. Subjekti ka per qellim ushtrimin e projektit "Perpunim i metaleve". E rendesishme eshte te theksojme se rrethimi i ambientit, ku eshte i ndertuar objekti dhe do te ushtrohet aktiviteti nga ky subjekt do te sjelle nje impakt estetik pozitiv ne krahasim me gjendjen e meparshme, duke kontribuar e ndikuar ne zhvillim racional dhe pozitiv te kesaj zone. Investitori privat ka kryer te gjitha studimet perkatese dhe ka bere studimin e infrastruktures inxhinjerike, si dhe studimin e qendrushmerise se tokes, para se te filloje nga puna e aktivitetit "Perpunim i metaleve".

APM shpk është një kompani me aktivitete në fushën e industrisë mekanike që nga viti 1696 dhe ka ruajtur të njëjtën strukturë produkti edhe pas privatizimit të saj të plotë në Nëntor 2001. Produktet e saj kryesore janë :

- Perpunim i çeliqueve si: **prerje, çpim, tornim, frezim, montim, saldim, lyerje.**
- Prodhim i konstruksioneve metalike.
- Prodhim i eneve Me dhe Pa presion
- Prodhim depozita uji, karburanti.
- Prodhim separator gazi.
- Prodhim tubacione te ndryshme çeliku
- Prodhim shtylla per industrine e prodhimit te energjise elektrike nga Era
- Prodhim detale çeliku pe industrine e prodhimit te makinave
- Prodhim detale çeliku per industrine e naftes dhe Gazit
- Sherbime te ndryshme ne konstruksione çeliku.

-Perskrimi i teknik i prodhimit te nje shtylle

Faza e pare: Zhvillimi i projektit

- VLERESIMI I BAZES MATERIALE
- MARJA E OFERTAVE NGA FURNITORET E MUNDSDHEM
- TRANSPORTI I MATERIALEVE DERI NE DESTINACION (APM)
- SISTEMIMI I MATERIALEVE SIPAS RADHES SE PUNES



Foto nga magazine ku mbahen materialet qe duhen per pune



Ambjentet e brendshme te oficines



Magazিনি i bazes materiale

Faza e dyte: Prodhimi i elementeve deri ne parafabrikimin e tyre

1. PERPUNIMI I MATERIALEVE NE MAKINERINE E PLAZMA PROMOTEC
 - REALIZIMI I PROGRAMIT PER PRERJEN E ELEMENTEVE PERKATES
 - EKZEKUTIMI I PROGRAMIT NGA OPERATORI
 - KONTROLLI I PRODUKTEVE TE PRERA DUKE IU REFERUAR STANDARTIT PERKATES DHE TOLERANCAVE TE LEJUARA
 - MBAJTIA E RAPORT KONTROLL PER CDO PRODUCT.



Makinera e prerjes Plazma Promotec

2. PASTRIMI NE MAKINERINE E RERES (ROSLER)
 - PASTRIMI I SIPERFAQES SE MATERIALIT DERI NE 15-25 MIKRON
 - KONTROLLI I SIPERFAQES SE PASTRUAR BRENDA NORMAVE TE PARAPERCAKTUARA NGA STANDARTI
 - MBAJTIA E RAPORTIT PERKATES PER CDO ELEMENT.
 - VLERESIMI I NDOTJES DHE MATJA E ZHURMAVE SIPAS NORMAVE TE LEJUARA NGA ISO



Makineria e Pastrimit me rere abrasive (D0.5-1.5mm)

3. MARKERIMI I LLAMARINAVE SIPAS STANDARTIT DHE KODIT PER SECILEN LLAMARINE QE VJENE NGA PRODHUESI .
 - RAPORTI I GJURMUESHMERISE SE MATERIALEVE
4. PERGATITJA E ZMUCOVE TE SALDIMIT.

- PERGATITJA E ZMUCOVE TE SALDIMIT NE VENDOSUR NGA PROCEDURA E SALDIMIT
 - KONTROLLI I ZMUCOVE TE SALDIMIT ME CALIBER PERKATES
 - VLERESIMI I NIVELIT TE ZHURMAVE DERI NE NORMEN E LEJUAR 60-70 DB
5. KALANDRIMI I BREZAVE(LLAMARINAVE)
- PERGATITJA E SHABLLONEVE SIPAS DIAMETRAVE TE BREZAVE
 - KALANDRIMI I BREZAVE BRENDA TOLERANCAVE TE PARAPERCAKTUARA NGA STANDARTI EN 1090-2-2008 CLASS C.
 - KALANDRIMI I ELEMENTEVE TE TJERE SI SUPORTET E BAKAPORTES.
 - KALANDRIMI I PROFILEVE L SIPAS SHABLLONIT (DIAMETRI I BRENDSEM E RVM)



Kalandra



Breza te kalandruar

6. PERGATITJA E FLLANXHAVE NE TRAPANIN RADIAL
- MATJA E PARAPRAKE E PERMASAVE KRYESORE TE FLLANXHAVE (DJ, DB)
 - SHPIMI I FLLANXHAVE SIPAS PROJEKTITTE DHENE NGA PROJEKTUESI
 - KONTROLLI I PERMASAVE SPECIFIKE TE FLLANXHAVE
 - PERGATITJA E RAPORTIT PER SECILEN FLLANXHE
7. PERGATITJA E ZMUCOVE PER SALDIM TE FLLANXHAVE .
- SMUCIM I FLLANXHAVE SIPAS PROCEDURES SE SALDIMIT
 - TRANSPORTI I TYRE PER NE ZONEN E PARAFABRIKIMIT.
8. MAGAZINIMI I MATERIALEVE TE NGJYSEM PERGATITURA NE ZONEN E PARAFABRIKIMIT
- NE KETE ZONE TE GJITHA MATERIALET JANE GATI PER MONTIM DHE SALDIMIN E TYRE



Parafabrikimi

Faza e trete: Montimi dhe saldimi i brezave dhe elementeve te tjere plotesues

1. MONTIM

- MONTIM I BREZAVE DHE SALDIMI I TYRE ME “SPOT WELD “ ME SEGMENTE
- MONTIM I BREZAVE ME FLLANXHAT PERKATESE
- MONTIM I ELEMENTEVE TE TJERE SIPAS PROJEKTIT
- KONTROLI I DEFORMACIONEVE TE MUNDSHME QE MUNDE TE JENE KRIJUAR GJATE MONTIMIT DHE RIPARIMI I TYRE
- PERGATITJA PER SALDIM

2. SALDIMI

- PROCESI I SALDIMIT BEHET NE DY MENYRA
 - SALDIMI SIPAS PROCESIT TE SALDIMIT MAG
 - SALDIMI SIPAS PROCESIT TE SALDIMIT SAW
 - KONTROLI I DEFORMACIONEVE MBAS SALDIMIT
 - PERGATITJA E RAPORTIT NGA PERSONI PERGJEGJES (QUALITY CONTROL)



Montim dhe saldim i shtyllave

3. KONTROLLET E SALDIMEVE ME METODAT PA SHKATERRIM

- PERGATITJA E RAPORTIT TE TESTIT VISUAL (KU ELEMINOHEN DEFEKTET SIPERFAQESORE TE LINJAT E SALDIMEVE APO NE SIPERFAQET E LLAMARINAVE SIPAS STANDARTIT ISO 5817:2003
- KONTROLLI ME METODEN PA SHKATERRIM X-RAY(RREXE X)
- KONTROLLI ME METODEN PA SHKATERRIM UT (ULTRASONIC)
- RIPARIMET E MUNDSHME NESE DO DEFEKTE NE NYJAT E SALDIMIT.
- PERGATITJA E RAPORTIT PER SECILEN NYJE APO SEGMENT SALDIMI.
- PASTRIMET E RVM NGA SPERKATJET E SALDIMIT

Faza e katert: Pergatitja per lyerjen e shtylles

1. PERPARA PROCESIT TE LYERJES SIPERFAQES I NENSHTROHET PROCESI I PASTRIMIT ME RERE ABRASIVE (MADHESIA E RERES 05-1.2 MM) NE MENYRE MANUALE .
 - KONTROLLI DHE PERGATITJA E RAPORTIT SIPAS STANDARTIT ISO 11127-6
 - PASTRAMI ME AJER I SIPERFAQES QE DO TE LYHET
2. KONTROLLI I PARAMETRAVE TE PUNES
 - KONTROLLI I LAGESHTISE SE AJRIT
 - KONTROLLI I TEMPERATURES SE AJRIT
 - PERGATITJA E BOJES NGA DY KOMPONENTE SE BASHKU.
3. LYERJA E SHTYLLES .
 - PROCESI I LYERJES DO TE ZHVILLOHET NE DISA HAPA NE FUKSION TE TRASHESIS SE BOJES PER CDO SHITRESE TE LYER.

- LYERJA E SHITRESES SE PARE ME BOJE ANTIKORRODIVE (BRENDA –JASHTE TUBIT) TRASHESIA E KRIJUAR DERI NE 35 MIKRON
- LYERJA E DORES SE DYTE ME BOJE ANTIKORRODIVE (BRENDA –JASHTE TUBIT) TRASHESIA E KRIJUAR DERI NE 60-70 MIKRON



Foto nga procesi i lyerjes

SHENIM: KOHA NGA NJERA SHITRESE NE TJETREN ESHTJE JO ME PAK SE 4 ORE

- KONTROLLI I PARAMETRAVE TE LAGESHTISE SE AJRIT DHE TE TEMPERATURES
- LYERJA E SHITRESES SE PARE NGA JASHTE ME BOJE DY KOMPONENTE RAL 9010 DERI NE TRASHESINE 70-80MIKRON
- LYERJA E SHITRESES SE DYTE NGA JASHTE ME BOJE DY KOMPONENTE RAL 9010 DERI NE TRASHESINE 70-80MIKRON

SHENIM : KOHA E LYERJES NGA NJERA SHITRESE TEK TJETRA ESHTJE JO ME PAK SE 5 ORE

MBAS PERFUNDIMIT TE PROCESIT TE LYERJES SEKSIONET I NXJERRIM NGA DHOMA E LYERJES BEHET MONTIMI I SEKSIONEVE BRENDA NJERI TJETRIT SIPAS METODEDES TE DHENE NGA PROJEKTUESI .

MBAS PERFUNDIMIT TE KETIJ PROCESI PRODUKTI ESHTJE GATI PER PROCEDURAT E TRANSPORTIT.



Foto e produktit perfundimtar

-Sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit
- Sasite e lendeve te para

Si lende te pare perdoren produktet e hekurit dhe celikut te cilat sigurohen nga importi dhe tregu vendas te cilat shoqerohen me certifikaten e cilesise si:

1. Llamarina metalike
2. Prokate Celiku
3. Profile celiku
4. Tubo celiku me seksion katror apo rrethor

Lendë ndihmëse në përpunim: Janë të gjitha veglat e punës që janë lëndë konsumi që duhen për të zhvilluar aktivitetin të tilla janë të shumta ku përfshijne të gjithë gurët smerilues, pasta të ndryshme pastrimi, vaj për mirëmbajtjen e makinerive e të tjera si këto.

Produktet perfundimtare mund te jene:

- Ene me dhe pa presion
- Depozita uji, karburanti
- Separator gazi
- Tubacione te ndryshme çeliku etj. Kjo ne varesi te porosive te klienteve.

Sasite e lendeve te para veren nga porosite qe bejne klientet, pra nuk eshte sasi fikse.

- e) **Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja**

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik

Energjia qe do te perdoret do te jete energji elektrike e cila do te sigurohet nga rrjeti energjistik i zones ne fjale komform te gjitha rregullave.

Furnizimin me uje

Furnizimi me uje i objekteve te trajtimit do te kryhet nga rrjeti i ujesjelles kanalizimeve duke lidhur nje kontrate, ai do te perdoret per procesin e punes, per nevoja sanitare dhe per ujitjen e pemeve, per kete qellim jane planifikuar investime.

Shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve

Sasia e ujerave te ndotur ujerave sanitare do te behet perseri ne rrjetin e kanalizimeve ndersa per sa i perket mbetjeve urbane ato do te grumbullohen e do te cohen ne vendepozitimet e qeverisjes vendore. Per te minimizuar shkallen e ndotjes nga djegia e karburanteve te makinerive do te merren masa.

Zhurmat

Burimi kumuluar i zhurmave nga puna e njekoheshme e makinerive ne distance 7 m nga to, eshte **180 dB**. Duke mare parasysh shprehjen e nivelit te intensitetit akustik te nje zhurme me relacinin me poshtem:

$$L = 10 \lg (I_1/I_0) \text{ ku}$$

Ku:

L - Niveli akustik i zhurmes te marre ne konsiderate.

I₁ - Intensiteti akustik izhurmave te kumuluar.

I₀ - Intensiteti akustik i references.

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 200-2000 Hz, e cila e shte e pranueshme nga veshi i njeriut. Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve, mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme. Teknologjia shfrytezimit te aktivitetit nuk parashikon perdorimin e ujit. Ujrat e reshjeve do te dekantohen ne gropa

brenda zones pastaj rrjedhja e metejshme e tyre do te behet ne perputhje me rrjedhen natyrale te tyre me ane perroit qe kalon aty prane.

Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialeve qe krijohen gjate hapjes dhe shfrytëzimit te aktivitetit

Mbeturinat qe do te dalin nga proçesi i shfrytezimit te ketij aktiviteti fillimisht do te dpozitohen ne sheshe te veçanta provizore dhe mandej sapo te krijohet hapsira e nevojshme e shfrytezimit per vendosjen e tyre do te vendosen atje, te gjitha mbetjet qe dalin nga ky aktivitet jane te riciklueshme. Ndersa per sa i perket mbetjeve urbane qe vijne nga konsumi i perditshem i puntoreve ato do te hidhen ne vendet e posacme Brenda territorit te aktivitetit dhe me pas do te cohen ne vendepozitimin e vendosur nga pushteti vendor.

- f) Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit**

Ky subjekt nuk do te kryej punime ndertimi pasi sic e kemi permendur edhe me siper infrastruktura per kryerjen e ketij aktiviteti eshte e ngritur nga subjekti qe e ka dhen me qera.

Kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit, Përcaktimi i kapacitetit prodhues

Funksionimi i ketij aktiviteti mendohet te jete per nje kohe relativisht te gjate, dhe nese ky subject nuk do te zhvilloj me kete aktivitet struktura e cila eshte e ngritur mund te perdoret per te njejtat qellime nga subjekte te tjera.

- g) Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projekti**

Përshkrimi i objekteve ndihmese

- a) Per projektin ne fjale nuk jane planifikuar sistemime për sheshet e ndërtimit te objekteve sipërfaqësore. Sepse objekti eshte ekzistues dhe e ka strukturen e ngritur, ku do te punohet per perpunimin e e metaleve.

- h) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)**

sic e kemi permendur edhe me siper ky subjekt nuk do te kryej ndertime te reja sepse jane ekzistuese dhe si pasoje nuk do te perdore lende te para per ndertim.

j) Informacion lidhur me alternativat e marra ne konsiderate persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Zgjedhja e menyres se shfrytezimit te kasaj zone per ushtrimin e ketij aktiviteti eshte bere pasi kjo zone eshte zone industriale plus kesaj ne kete vend ndodhet dhe struktura e ngritur per ushtrimin e ketij aktiviteti.

k) Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Ky aktivitet eshte aktivitet i prodhimit dhe perpunimit te metaleve. Lendet djegese qe perdorin mjetet e transportit sigurohet ne pikat e furnizimit me karburant.

Lendet e para ndihmese te konsumuara per proceset e punes jane:

1. Lllamarina metalike
2. Prokate Celiku
3. Profile celiku
4. Tubo celiku me seksion katror apo rrethor etj.

l) Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Zhvillimi i ketij projekti nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se shfrytezimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi dhe gjithashtu te punesuarit jane nga zona perreth aktivitetit dhe do te punojne vetem me nje nderese ne dite.

m) Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Subjekti ne fjale nuk disponon Leje Mjedisi tani po ndjek procedurat per tu paisur me te si ne kete rast qe subjekti APM SHPK kerkon te paiset me Vendim Mjedisor per Prodhimin dhe perpunimin e metaleve dhe pas kesaj te ndjeke procedurat per tu paisur me Leje Mjedisi.

